

Vendodhja e Atletëve

NJE VESHTRIM





Atletët janë ambasadorë dhe shembuj. Ata kanë një përgjegjësi të rëndësishme në mbrojtjen e integritetit të sportit të tyre. Pjesë e këtij detyrimi do të thotë, që ju tani do të duhet të jepni detaje të vendndodhjes, në mënyrë që autoritetet anti-doping të sigurojnë që të gjithë atletët bëjnë lojë të ndershme.

Pse Vendndodhja?

Dhënia e vendndodhjes ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtës tuaj për një sport të pastër. Informacionin i vendndodhjes i jep mundësinë Organizatës Anti-Doping (ADO) për të gjetur atletët pa i njoftuar, e cila është jetike për testimin e atletëve të cilët zgjedhin të mashtrojnë veten me doping.

Njohja se ku mund të gjenden atletët për testim është vendimtare për të siguruar programe efektive anti doping.

Kush është Përfshirë?

Shumë pak atletë janë të regjistruar në Listën e Regjistruar për Analiza (RTP) dhe nevojitet të japin informacion aktual dhe të saktë mbi vendndodhjen.

Federatat Ndërkombëtare dhe Organizatat Kombëtare Anti-Doping janë përgjegjëse për të përcaktuar nëse ju duhet të jepni informacione mbi vendndodhjen apo jo.

Çfarë informacioni duhet të jap?

Nëse ju kërkohet të jepni informacion mbi vendndodhjen tuaj nga Organizata juaj Anti Doping, ju duhet të jepni informacione të tilla si:

- adresa e shtëpisë
- informacion mbi trajnimin dhe vendndodhjen
- kalendari i aktiviteteve sportive
- aktivitetet e rregullta personale të tilla si puna apo shkolla
- Për ata pak atletë të përfshirë në Listën e Regjistruar për Analiza, duhet të sigurohet një afat 60-minuta në ditë, ku ju duhet të jeni në dispozicion për testim.

Mos harroni se të gjithë atletët mund të testohen në çdo kohë dhe kudo. Megjithatë, për atletët e përfshirë në Listën e Regjistruar për Analiza, një test i humbur mund të raportohet në qoftë se ju nuk jeni në dispozicion gjatë periudhës prej 60 minuta që keni deklaruar.



Disa fakte të shpejta në përditësimin e vendndodhjes tuaj

Vendndodhje



- Ju mund të përditësoni të dhënat mbi vendndodhjen tuaj, thjesht duke dërguar një SMS në Organizatën tuaj respektive Anti Doping, ose duke përdorur aplikacionin mobile të WADA-s.
- Mund të ketë pasoja nëse nuk jeni të pranishëm pa një arsye të vlefshme. Në qoftë se ju nuk mund të gjendeni për testim, ju keni mundësinë për të shpjeguar pse.
- Ju mund të zgjidhni të keni agjentin tuaj ose përfaqësues tjetër që të paraqesë vendndodhjen tuaj për ju, por keni parasysh se ju jeni ende përgjegjës për këtë informacion.
- Nëse ju jeni pjesë e një ekipi, informacioni juaj mbi vendndodhjen mund të dorëzohet nga një trajner apo zyrtar ekipi në kuadrin e paraqitjes kolektive të ekipit tuaj.

Përditësimi i Vendndodhjes tuaj është i lehtë me anë të



A D A M S

Sistemi i Menaxhimit dhe Adiministrimit Anti Doping të WADA, është një mjet online që atletët mund ta aksesojnë kudo dhe kurdo për të përditësuar informacionin mbi vendndodhjen, përfshirë nëpërmjet SMS. ADAMS është e disponueshme në gjuhën Angleze, Franceze, Spanjolle, Arabe, Holandeze, Gjermane, Filandeze, Italiane, Japoneze dhe Ruse.

ADAMS është falas, i lehtë për tu përdorur, dhe kontrolli multi-nivel i aksesit siguron privacinë dhe sigurinë e informacionit tuaj. Pyesni organizatën tuaj respektive anti-doping nëse ADAMS është diçka që po përdorin apo do të përdorin të në ardhmen.



Find out more at wada-ama.org

Mos Harroni!

Vendodhja e atletëve është një hap vendimtar në sigurimin se sporti dhe konkurrentët tuaj qëndrojnë në nivelin e lojës.

- Ju dhe vetëm ju, jeni përgjegës për vendodhjen tuaj
- Ju nuk mund të fajësoni përgjegjësin apo agjentin tuaj për pasaktësi në plotësim apo harresë për përditësim të vendodhjes.
- Nëse jeni të përfshirë në Listën e Regjistruar për Analiza, duhet të jepni vendodhjen tuaj çdo tre muaj në mënyrë që të gjendeni për testim.
- Nëse jeni të përfshirë në Listën e Regjistruar për Analiza, MBANI MEND, mund të ketë pasoja për mos plotësim të saktë të informacionit të vendodhjes. Federata juaj Ndërkombëtare dhe Organizata juaj Kombëtare Anti Doping mund t'ju sigurojë informacione të detajuara për kërkesat e tyre.
- Informacioni mbi vendodhjen është një element vendimtar në mbështetjen e sportit të pastër.



Në rast të ndonjë mospërputhje në mes të këtij informacioni dhe të Kodit Botëror Anti-Doping, Kodi mbizotëron. Ky informacion është subjekt ndryshimi në çdo kohë. Gjithmonë kontrolloni me Federatën tuaj Ndërkombëtare, Organizatën Kombëtare Anti-Doping ose Federatën Kombëtare për rregullat më të përditësuara anti-doping.



WADA

wada-ama.org • info@wada-ama.org
facebook.com/wada.ama • twitter.com/wada_ama

Headquarters 800 Place Victoria, Suite 1700, P.O. Box 120, Montreal, QC, H4Z 1B7, Canada Tel.: +1.514.904.9232 Fax: +1.514.904.8650

Africa Protea Assurance Building, 8th Floor, Greenmarket Square, Cape Toën, 8001, South Africa Tel.: +27.21.483.9790 Fax: +27.21.483.9791

Asia/Oceania C/O Japan Institute of Sports Sciences, 3-15-1 Nishigaoka, Kita-Ku, Tokyo, 115-0056, Japan Tel.: +81.3.5963.4321 Fax: +81.3.5963.4320

Europe Maison du Sport International, Avenue de Rhodanie 54, 1007 Lausanne, Sëitserland Tel.: +41.21.343.43.40 Fax: +41.21.343.43.41

Latin America Ëorld Trade Center Montevideo, Toëer II, Unit 712, Calle Luis A De Herrera 1248, Montevideo, Uruguay Tel.: +598.2.623.5206 Fax: +598.2.623.5207



Find out more at wada-ama.org